



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:215771

Datë: 21.02.2025

Numri i dokumentit: 06881857

Ac.nr.4482/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, kolegji në përbërje nga gjyqtari Malsor Kryeziu – kryetar i kolegjit dhe gjyqtarëve Besnik Bislimaj dhe Rafet Haxhaj – anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit S.C., nga P., të cilin me autorizim e përfaqëson B. S., avokat në P., rruga “...”, kompleksi “Q.”, K-I, nr., kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme – Policia e Kosovës, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit N. K., nga Avokatura Shtetërore, për kompensimin e dëmit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.2507/17, të datës 21.04.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 18.02.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme – Policia e Kosovës, me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.2507/17, i datës 21.04.2022, në pikën e I-rë dhe të II-të, të dispozitivit, VËRTETOHET.

II. Pika e III-të e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.2507/17, të datës 21.04.2022, mbetet e pa shqyrtuar.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.2507/17, të datës 21.04.2022, ka vendosur si vijon: ”.....me pikën I të dispozitivit gjykata e shkallës së parë e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit S.C., nga Prishtina dhe e ka detyruar të paditurën Ministria e Punëve të Brendshme – Policia e Kosovës, me seli në Prishtinë, që paditësit në emër të kompensimit të dëmit jo material dhe material të pësuar si pasojë e incidentit i cili ka ndodh me datë 09.01.2016, t’ia paguaj shumat e specifikuar si më poshtë dhe atë: Dëmi jo material: - kompensim në emër të dhimbjeve të

përjetuara fizike, shumën prej 1,140 €, - kompensim në emër të frikës së përjetuar, shumën prej 915 €. Dëmi material: - kompensim në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj, shumën prej 175 €, - kompensim në emër të ushqimit të përforcuar, shumën prej 175 €, - kompensim në emër të shpenzimeve të mjekimit, shumën prej 10 €. Në pikën II të dispozitivit e ka detyruar të paditurën që paditësit, shumat e gjykuara sikurse në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, t'ia paguaj me kamatë ligjore prej 8% në vit dhe atë në emër të dëmit jo material, duke filluar nga data 21.04.2022 (data e marrjes së aktgjykimit), e deri në pagesën definitive, ndërsa në emër të dëmit material duke filluar nga data 26.09.2017 (data e paraqitjes së padisë), si dhe shpenzimet e procedurës në lartësi prej 849.60 €, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbaramit me detyrim. Në pikën III e ka refuzuar pjesën e kërkesëpadisë së paditësit dhe atë për dhimbjet e përjetuara fizike, në shumë prej 3,860 €, në emër të kompensimit për frikën e përjetuar, në shumë prej 3,085 €, në emër të kompensimit për ndihmë dhe kujdes të huaj, në shumë prej 25 €, në emër të ushqimit të përforcuar, në shumë prej 25 €, në emër të rehabilitimit klimatik në shumë prej 300 €, si dhe në emër të shpenzimeve të procedurës në shumë prej 104 €, si të pa bazuar.....”...

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura, në afatin e paraparë ligjor ka paraqitur ankesë dhe atë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikim i gabuar i të drejtës materiale, duke propozuar që Gjykata e Apelit të aprovojë ankesën, të e prish aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë në pikën I dhe II të dispozitivit dhe të e refuzoj në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pabazuar, ose të e hedh padinë në mungesë të legjitimitetit.

Përgjigje në ankesë nuk ka ushtruar pala paditëse.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- Ankesa e të paditurës, është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi S.C., nga Prishtina, përmes të autorizuarit të tij, në gjykatën e shkallës së parë më datë 26.09.2017, ka paraqitur padi për kompensimin e dëmit kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme – Policia e Kosovës, me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit ti kompensoj dëmin jo material dhe material me kamatë ligjore si dhe kompensimin e shpenzimeve procedurale. Në ndërkohë pas marrjes së ekspertizës mjekësore në seancën kryesore me dt.10.02.32022, bënë precizimin e lartësisë së kërkesëpadisë më saktësisht si në aktgjykimin e atakuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vendosur sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit kryesor dhe pas administrimit të provave, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar C.nr.2507/17, të datës 21.04.2022, me të cilin është aprovuar pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit në fjalë.

Në arsyetim të aktgjykimit është theksuar se me provat e administruara gjykata ka gjetur se me 09.01.2016, rreth orës 15:25, në sheshin “Skënderbeu”, në Prishtinë, paditësi është goditur nga një siguresë e gazit lotsjellës dhe për pasojë kishte pësuar lëndime trupore. Deri të kjo gjendje faktike gjykata ka ardhur duke u mbështetur në këto prova të cilat i ka pranuar si të besueshme dhe atë: Raporti nga QKUK-ja, në Prishtinë, me nr. 1124, i datës 09.01.2016, me të cilin vërtetohet fakti se paditësi për shkak të lëndimeve trupore në vendin e punës në protestë, sillet në Qendrën Emergjente. Gjkata nga provat e administruara dhe atë nga Vendimi, lëshuar nga Komisioni i Brendshëm Disiplinor, i datës 14.08.2017, ka vërtetuar faktin se paditësi me datë 09.01.2016, në Prishtinë, në protestën e organizuar ka qenë i angazhuar si kameraman i TV “Rrokum” dhe kishte qëndruar se bashku me një koleg gazetar nga i njëjti medium, kishte përcjell nga afër dhe e kishte bërë xhirime të protestës, po ashtu në këtë vendim është cekur se në bazë të xhirimeve të siguruara në ditën kritike, ankuesi tani paditësi kishte qenë duke filmuar si kameraman, por nuk është vërejtur se i njëjti a kishte pas ndonjë ID zyrtare apo jelek identifikues, po ashtu është theksuar se për shkak të angazhimit të shumë njësive speciale operative si dhe përdorimit të pajisjeve të specializuara policore, nuk është vërtetuar se cili zyrtar policor ditën kritike e kishte përdorur – gjuajtësin e gazit lotsjellës nga e cila ishte goditur tani paditësi. Po ashtu edhe nga provat e tjera të administruara lëshuar nga e paditura gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi me datë 09.01.2016, ka qenë i angazhuar si kameraman në TV “Rrokum” dhe ka qenë duke xhiruar, së bashku me një koleg të tij gazetarin T. O. dhe rreth orës 15:30, ishte goditur në këmbën e majtë nga një siguresë nga metali, e cila kishte ardhur nga drejtimi ku Policia e Kosovës, po intervenonte, në të cilat prova është theksuar se në bazë të planit operativ me urdhër të komandantit taktik në teren, përpos NJSO-ve, të Policisë, janë përdorur uniforma mbrojtëse, gazi lotsjellës, mjetet e blinduara, topi i ujit, si dhe bocat kundër zjarrit, por për shkak të angazhimit të shumë njësive speciale operative nuk është vërtetuar se cili nga zyrtaret Policor, e ka përdorur gjuajtjen e gazit lotsjellës. Për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike se paditësi me datë 09.01.2016, a ka qenë i angazhuar si kameraman në TV “Rrokum” dhe a kishte të vendosur ID, apo a kishte të veshur jelek identifikues, sipas propozimit të përfaqësuesit të paditësit, gjykata ka marr provën përmes dëgjimit të dëshmitarit Taulant Osmani, i cili në gjykatë ka deklaruar se me datë 09.01.2016, ka qenë në marrëdhënie pune në TV “Rrokum”, si gazetar, e po ashtu në këtë TV, në marrëdhënie pune ka qene edhe paditësi si kameraman, ka deklaruar se me datë 09.01.2016, kanë qenë në teren dhe paditë ka pësuar lëndime trupore, duke shtuar se kanë pasur një distancë 20 – 30 metra nga protestuesit dhe kanë pasur të vendosur ID dhe se paditësi e ka pasur të veshur edhe jelekun me shkrimin “Press”. Deklaratën e dëshmitarit gjykata e ka pranuar në tersi si të besueshme pasi që i njëjti ishte bindes dhe dëshmia e tij përputhet edhe me faktet e tjera të provuara në këtë çështje juridike – kontestuese. Andaj baza juridike e kërkesëpadisë, që e paditura, të jetë përgjegjëse për ta kompensuar paditësin gjene mbështetje në dispozitat nga neni 136, 137, 140 dhe 161 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, pasi që nga të gjitha provat e administruara e të cilat i ka lëshuar e paditura gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi me datë 09.01.2016, ka qenë i angazhuar si kameraman në TV “Rrokum” dhe i cili ishte goditur nga një siguresë e gazit lotsjellës, lëshuar nga punonjësi i të paditurës. Për lartësinë e kërkesëpadisë së paditësit është bazuar në mendimin e ekspertëve mjekësor Dr. M. H., Ortoped - Traumatolog dhe Dr. V. R., Psikiatër. Për shpenzime mjekësore ka vendosur duke u bazuar në provat e ofruara nga pala paditëse. Gjkata e shkallës së parë vendimin e saj e ka bazuar në nenet 136, 173 dhe 183 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e

Detyrimeve (LMD) dhe neneve 9 dhe 10 të LSDA-së, lidhur me nenin 143 të LPK-së. Për kamatën ka vendosur duke u bazuar në nenin 382 të LMD-së. Për shpenzime ka vendosur në kuptim të nenit 449 dhe 452 e lidhur me nenin 463 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pikat (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, e për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore. Aktgjykimi nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitiv i aktgjykimit është i qartë dhe i përmbarueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për të gjitha faktet vendimtare, të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosur lidhur me themelësinë e pjeërishme të kërkesëpadsisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Gjykata në arsyetim të aktgjykimit të atakuar ka paraqitur arsye mjaftueshme në lidhje me bazën e kërkesëpadsisë dhe lidhur lartësinë e dëmit jo material dhe material si dhe ka dhënë arsye të mjaftueshme për shumat e aprovuara për llojet e dëmit dhe format e tij të kërkuara nga paditësit.

Gjykata e Apelit, ekzaminoj aktgjykimin e ankimuar edhe në raport me pretendimet tjera të paditurës lidhur me shkeljen e parimit të kontradiktorialitetit për shkak se nuk ka trajtuar të gjitha pretendimet e të paditurës përgjatë shqyrtimit kryesor, mirëpo të njëjtin e gjeti si pretendim të pabazuar, kjo sepse gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar është thelluar në masë të mjaftueshme duke trajtuar në mënyrë të drejtë dhe të barabartë çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse si për nga gjendja faktike ashtu edhe për nga zbatimi i të drejtës materiale.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës për konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes janë provuar me prova përkatëse të cilat janë administruar në një proces të rregullt gjyqësor. Përgjegjësinë e të paditurës gjykata e ka vërtetuar përmes provave të administruara dhe të cilat janë lëshuar nga vet e paditura, përmes të cilave vërtetohet se deri tek lëndimi i paditësit ka ardhur kur paditësi me datë 09.01.2016, ka qenë i angazhuar në cilësinë e kameramanit në TV “Rrokum” dhe duke xhiruar së bashku me kolegun e tij gazetarin Taulant Osmani, i njëjti është lënduar nga punonjësit e të paditurës në protestën e organizuar me këtë datë, nga një siguresë metalike e gazit lotësjellës të cilën e kanë përdorur punonjësit e të paditurës, e nga ky lëndim ka pësuar lëndime trupore. Gjendjen faktike për dëmin jo material dhe material gjykata e shkallës së parë e ka provuar përmes mendimit të ekspertëve mjekësor të cilët pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit, kanë dhënë mendimin dhe konstatimin e tyre lidhur me natyrën e lëndimit, kohëzgjatjen e intensitetit të dhimbjeve fizike si dhe frikën e

pësuar, nevojën për ushqim të përforcuar si dhe nevojën për kujdesin e huaj. Në rastin konkret lëndimet të cilat i ka pësuar paditësi kanë qenë lëndime të lehta trupore, me pasojat të cilat më detajisht i ka arsyetuar gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e saj. Po ashtu edhe shpenzimet mjekësore mjekësore nuk ka qenë kontestuar nga e paditura. Gjykata e shkallës së parë, ka dhënë shpjegimet e duhura në arsyetim të aktgjykimit, për shumat e gjykuara sipas kategorive të dëmit si përfundim e ka marrë për bazë mendimin e ekspertëve mjekësore, prandaj në këtë kontekst edhe Gjykata e Apelit i ka pranuar si të rregullta dhe të drejta vlerësimet e gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e Apelit i vlerëson si të pa qëndrueshme pretendimet ankimore të të paditurës për zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Kjo për faktin se në kuptim të dispozitave materialo-juridike të cilave u është referuar gjykata e shkallës së parë e në përputhje me gjendjen faktike, duke marrë në konsideratë natyrën e lëndimeve të lehta dhe rrethanat tjera që ndikojnë në përcaktimin e lartësisë së kompensimit siç janë natyra dhe kohëzgjatja e dhimbjeve fizike, lloji, intensiteti dhe kohëzgjatja e frikës si dhe rrethanat tjera, si: mosha e paditësit dhe praktika gjyqësore të cilat rezultojnë se shumat e gjykuara janë në përputhje me qëllimin e kompensimit. Gjykata ka vendosur në mënyrë të ekuilibruar në mes të shumave të gjykuara dhe natyrës së lëndimeve përkatësisht dëmeve që ka pësuar paditësja, duke siguruar që kompensimi i gjykuar të jetë satisfaksion për paditësin, duke shmangur qëllimet tjera materiale (lukrative) që mund të bien ndesh me qëllimin e satisfaksionit në raste të tilla.

Kamata është vendosur drejtë në kuptim të nenit 382 të LMD.

Drejtë është vendosur edhe në raport me shpenzimet procedurale të aprovuara, i cili vendim është nxjerr në përputhje më veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK.

Nga sa u tha më lartë, Gjykata e Apelit gjeti se ankesa e të paditurës është tërësisht e pabazuar, për çka edhe u vendos sikurse në diapozitiv të këtij aktgjykimi, e në pajtim me nenin 194, 195 paragrafi 1 pika (d), në lidhje me nenin 200 të LPK.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.4482/2022, me datën 18.02.2025

Kryetari i kolegjit - Gjyqtari
Malsor Kryeziu